



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. ____ prot.

Belsh më: 14. 08 .2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-SHERBIM

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): pajisje per taksash, paketa software per pregatitje taksash

Vlera e fondit limit: 2 900 000(dy milion e nëntëqind mije)lekë pa TVSH.

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike ,kriteret e veçanta të kualifikimit është kryer nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit nr,2892 datë 12.08.2025 ,referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 te VKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, që përcakton “ cmimet e botuara nga instituti i statistikave (INSTAT) ,ose /dhe te tjera zyrtare ,të njohura nga institucionet perkatese ,(si,pershëmbull ,nga organet tatimore dhe doganore, dhomat e tregtisë , në manuale etj.

Ne bazë t ë nenit 21 ,pika2 ,neni 35 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ,neni 2, ,pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, tëVKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Belsh ka hartuar proceverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurë e sipërcituar, me përmbajtje si më poshtë :

Hartimi i dokumentave të tenderit u bë në përputhje me **ligjin Nr,162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurim Publik” si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar , ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional te operatoreve ekonomik:

Sipas përcaktimeve të bëra ne shtojcës 9) te DST-ve (Kriteret e Pergjithshme te perzgjedhjes /Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se , citojmë : ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në :a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtari profesionale;...2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët të regjistrohen në një nga regjistrat profesional ose tregtar.”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne vlerën e fondit limit të kësaj procedure , si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar me ligjin Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshimet në ligjin nr. 162/2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar,citojmë : 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në : b)**gjëndjen ekonomike financiare;**...3.Në lidhje me situatën ekonomike finaciare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe finaciari për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim Autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në vecanti që operatorët ekonomik të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomik të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomik nuk mund të tejkaloj dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitet ekonomik-finaciari” të vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se ,citojmë : “1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet finaciare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori për një periudhë maksimumi deri në 1(tre) vite e fundit finaciare.”

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” i ndryshuar

Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, VKM nr.922 datë 29.12.2017 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike “,si dhe kërkesave të ligjit nr.25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat finaciare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” ,i ndryshuar. Cdo tatim pagues për gatit deklaraten vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave , në zbatim të këtij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datë 31 mars të vitit pasardhës ,duke paraqitur në të njëjten kohë bilancin kontabel ,së bashku me anekset e tij ,si dhe cdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuar të bilanceve të 3(tri) viteve të fundit finaciare(2022,2023,2024) të shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, I ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Shënim:Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE Vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin

e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar “ I ndryshuar, ku parashikohet se:”Personat juridic që detyrohen për auditim ligjor të pasqyrave financiare detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspert kontabël ose shoqëri audituese.”c)shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite rradhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm:** i)totali I aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milion lekësh ; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milion lekësh ; iii)ja, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar.

Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar , Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006”Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “ për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore Brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me ankeset e tij, si dhe cdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Fiancës në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqëimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c) të Ligjit nr.1009/2009: “Personat juridik që detyrohen për auditim ligjor të pasqyrave financiare detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspert kontabël ose shoqëri audituese.”c)shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite rradhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm:** i)totali I aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milion lekësh ; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën.

2.2.3Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku te perfshihet kesti per periudhen perkatese te maturuar te viti 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Shënim: Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2,nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Njësia e prokurimit përcaktoi kritere që janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit të limit** të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin dhe faturat të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,sasitë, afati i përfundimit të kontratës .
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55 pika 4/b), të VKM Nr.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojëshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të

jenë në vlerën jo më të madhe se 20% e vlerës së fondit limit , që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi I vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore së sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjëndjes dhëe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët , nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

Përvoja e mëparëshme është një element I domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik mbi bazë të vlerave të kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitet për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një Bashkim operatorësh ekonomik sipas pikës 2 dhe 3 , të nenit 14 të LPP-së ku njëri prej të cilëve I përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhje, edhe gjatë zbatimit të kontratës.Në duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar nëpërmjet palëve.

Në nenin 55 “PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR” pika 4/b të vendimit të këshillit të ministrave me NR.285, DATË 19.05.2021“Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë :4. Në këtë lloj procedurë prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm .Lidhur me kërkesat për përvojat e ngjashme , vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara do të jetë: **b)Për kontratat e mallërave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është e realizuar gjatë tri viteve të fundit , nga data e shpalles së njoftimit të kontratës.**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal I kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për tu vendosur në DST . Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë detyruese, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e Prokurimit me objektin e mësipërme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te kete të punësuar jo më pak se 14 **punonjës** (perfshire edhe stafin e tij drejtues), për të cilët duhet të paraqesë:

- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per muajin e fundit te deklaruar, ku te percaktohet numri i punonjesve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të

garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) **një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj.** Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat si më poshtë:

- ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh
- ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni
- ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.
- ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
- ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit

- ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në piken 1 të nenit 44 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter kërkohej për të patur garancinë se malli që do të dorëzohet do të jetë brenda standarteve të kërkuara. *Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.* Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së shërbimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së shërbimeve që kërkohej të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto shërbime duke i dhënë besimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve blerësit (Autoritetit Kontraktor).

ISO/IEC 25001:2014 :

ISO/IEC 25001:2014 është një standard ndërkombëtar i njohur si "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Software-it". ISO/IEC 25001:2014 ka për qëllim të përcaktojë specifikat e përmbledhura për cilësinë e produkteve dhe sistemeve të software-it. Përmes këtij standardi, synohet të ndihmohet në hartimin dhe përdorimin e kritereve të cilësisë, si dhe në vlerësimin dhe testimin e cilësisë së software-it.

ISO/IEC 27018:2019:

ISO/IEC 27018:2019 është një standard ndërkombëtar i cili përfshin udhëzimet për menaxhimin e sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale në "cloud computing". Ky standard ka të bëjë me përpunimin e informacionit personal nga OE të "cloud

computing" dhe siguron një përcaktim të qartë të përgjegjësisë dhe detyrave të tyre në këtë kontekst. Ky standard ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë dhe privatësisë për personat e cilet janë përfshirë në përpunimin e të dhënave personale në mjediset e "cloud computing".

ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.

ISO 22301:2019 është një standard që specifikon kërkesat për të planifikuar, vendosur, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar vazhdimisht një sistem të dokumentuar të menaxhimit për të mbrojtur kundër, reduktuar gjasat e shfaqjes, përgatitjen, reagimin dhe rikuperimin nga incidentet përçarëse kur ato linden. Objektivi është të sigurohet elasticiteti dhe vazhdimësia nga OE gjatë ngjarjeve ose fatkeqësive të papritura, duke minimizuar ndikimin dhe kohën e ndërprerjes.

ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit

ISO/IEC 27001:2022 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit brenda kontekstit të organizatës.

ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

ISO 45001:2018 është një standard ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Ky standard është projektuar për të ndihmuar organizatat në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës duke përcaktuar dhe menaxhuar risket e mundshme. Përmes implementimit të këtij standardi, OE duhet të krijojë një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm në vendin e punës, duke ulur rreziqet dhe duke siguruar pjesëmarrjen aktive të punonjësve në proceset e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

ISO 9001:2015, siguron që operatori ekonomik ofron në mënyrë të vazhdueshme produkte dhe shërbime me cilësi të lartë, efikas, redukton gabimet dhe ruan një standard të lartë të ofrimit të shërbimit

ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit

ISO/IEC 20000-1:2018, fokusohet në Sistemet e Menaxhimit të Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSMS), duke ndihmuar OE të menaxhojë dhe ofrojë në mënyrë efektive

shërbimet e IT. Standardi përshkruan një sërë procesesh që OE duhet të krijojë për të siguruar dizajnimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin efikas të shërbimeve të TI-së. Qëllimi është të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të përmirësojë kënaqësinë e klientit dhe të sigurojë një ofrim të besueshëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të IT, duke i përafruar ato me kërkesat e biznesit dhe të klientit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë .Net me të paktën 5 vite ekperiencë (e provuar me CV, kontratë pune, diplomë, të deklaruar në listepagese).

Një zhvillues me këtë profil ka aftësinë të kuptojë dhe zbaton më mirë kërkesat e projektit, të identifikojë dhe zgjidhë problemet teknike me efikasitet dhe të kontribuojë në arkitekturën dhe dizajnin e sistemit. Kjo jo vetëm që rrit cilësinë dhe performancën e produktit përfundimtar, por gjithashtu siguron një proces zhvillimi më të qëndrueshëm dhe të optimizuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë React me të paktën 7 vite ekperiencë dhe i certifikuar me ISO 27001 (e provuar me CV, kontratë pune, të deklaruar në listepagese)

Zhvilluesi me përvojë në React do të jetë i aftë të ndërtojë ndërfaqe përdoruesi që janë jo vetëm responsive dhe intuitive, por edhe të optimizuara për performancë. Certifikimi ISO 27001 garanton që ky zhvillues është i njohur me standardet më të larta të sigurisë së informacionit, do të ndihmojë në garantimin e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të sistemeve dhe të dhënave, duke ofruar vlera të shtuara për të projektit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator me të paktën 5 vite ekperiencë (e provuar me CV, kontratë pune, të deklaruar në listepagese).

Zhvilluesi senior në teknologjinë Oracle Database Administrator do të ketë aftësinë të menaxhojë, optimizojë dhe sigurojë bazat e të dhënave në mënyrë efikase, duke garantuar performancë dhe stabilitet të lartë të sistemeve.

2.3.7 Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent (duke paraqitur certifikatën përkatëse dhe kontratë)

Certifikimi CISA vërteton se audituesi ka njohuri të thella dhe të gjerë në vlerësimin e rrezikut dhe kontrollit të teknologjisë së informacionit, duke siguruar që praktikat e auditimit janë në linjë me standardet ndërkombëtare. Ky ekspert është i pajisur për të identifikuar dobësitë në infrastrukturën e IT, të sugjerojë përmirësime dhe të monitorojë zbatimin e masave korrektive, duke ndihmuar OE të mbrojë pasuritë e saj digjitale, të përmbushë rregullativat dhe të përmirësojë proceset e biznesit për të arritur objektivat strategjike

II. Argumentimi specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga : Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlogaritjen e fondit limit, kriterëve të vecanta” mbështetur ne VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, në varësi të objektit të kontratës përcjell me procesverbalin Nr.2896Prot.,datë 12.08.2025 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike krijuar me urdhërin Nr. 2892 Prot., datë 12.08.2025.

*Specifikimet teknike të hartuara për shërbimin objekt prokurimi, përshkruajnë elementet me të rëndësishëm përbërës , që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 4 , pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 2 e VKM nr.285, date 19.05.2021”Per miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar cdo kërkesë funksionale ose performance, dhe cdo standard të kërkuar**, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.*

NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK: